



SBASHK Arsimimi sot

Tetor, 2024

Gazeta elektronike

Në SBASHK vendoset ashtu siç thotë anëtarësia



SBASHK / UESCK
Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës
The Union of Education, Science and Culture of Kosovo

Deklarim më shkrim për veprime sindikale

Me nënshkrimin tim, vullnetarisht deklaroj se në qoftë se më së largu 10.11.2024 dëshojnë përfaqësitë që në dialog social në mes të SBASHK dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të arrihet pajtueshmëri, që të realizohen kërkesat sona si anëtarë të SBASHK-ut për:

1. Nënshkrimin e Kontratës Kolektive të arsimit në Kosovë të dorëzuar në MASHTI më datën 02.10.2024.

2. Negocimin e vlerës së koeficientit të pagave për vitin 2025.

Obiligohet Kryetari i SBASHK-ut, që duke u bazuar në Ligjin për organizimin sindikal dhe Ligjin për Grevën, të fillojë menjëherë veprimet e përballëzueshme sindikale, duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme, ashtu saç thuhet në ligjet e lartcekura deri në realizimin e kërkesave tona.

Shoqata sindikale:

Komuna:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. personal	Telefoni	Nënshkrimi
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				

Gjatë muajit tetor SBASHK mbajti një numër të madh të trajnimeve për mësimdhënës



Gjatë muajit tetor, me kërkesë të mësimdhënësve anë e kënd Kosovës, SBASHK ka organizuar një numër të madh të ... (faqe 5)


Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës me kërkesa të qarta për Qeverinë e Kosovës



SBASHK ka mbajtur takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e të punësuarve në arsim, që nga çerdhet e deri edhe në universitete duke analizuar situatën aktuale e duke debatuar për kërkesat legjitime të anëtarësisë... (faqe 4)

Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës me seli në Bruksel, ka përgëzuar vazhdimisht SBASHK-un ... (faqe 6)

SBASHK vlerëson se rritja e paralajmëruar prej 55 euro e pagave është e papranueshme



Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut duke respektuar zërin tuaj ne ishim angazhuar që me shkresa e dialog të kërkojmë nga qeveria që vlera e koeficientit të pagave të shtohet për së paku 30 %, por ... (faqe 4)

SBASHK mbështet vlerat edukativo-arsimore.



Në kuadër të "Javës së Edukimit Global mbi Median dhe Informacionin", në Departamentin e Gazetarisë në UP janë prezantuar gjetjet e hulumtimit me titull ... (faqe 6)



Editorial

Vullneti dhe zëri i anëtarësisë



SBASHK-u vazhdimisht është angazhuar dhe ka vepruar duke u bazuar në vullnetin dhe zërin e anëtarësisë. Duke vazhduar me këtë qasje stafi qendror në komunikim me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve, mban takime të rregullta dhe analizon situatën aktuale dhe debaton e merr vendime bazuar në kërkesat dhe vullnetin e anëtarësisë. Kjo ndodh edhe me trajnimet, të cilat organizohen falë përkushtimit të stafit qendror, të trajnerëve dhe kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të universiteteve, që dërgojnë listat e atyre që kanë shprehur vullnet për të përcjell një trajnim të caktuar dhe pastaj vikendet kthehen në ditë pune e të angazhimeve.

Po ashtu duke respektuar vullnetin dhe zërin e anëtarësisë, SBASHK përgatitet edhe për angazhime të tjera. Në këtë rrjedhë të angazhimeve u mblodhën mijëra nënshkrime dhe u përgatit nisma qytetare lidhur me Projekt ndryshimin e Ligjit të

skemave pensionale, po ashtu u përgatit dhe u dorëzua në MASHTI, Draft Kontrata e re Kolektive e Arsimit. U dërguan kërkesa në Qeveri për ngritje të vlerës së koeficientit të pagave. U dërguan shkresa e shkresa për takime me institucionet, por ato vazhdojnë me qasjen e gabuar dhe me ikjen nga dialogu. Kjo ka bërë që Kryesia dhe stafi qendror t'i drejtohet prapë anëtarësisë dhe të shoh vullnetin e tyre. Janë shpërndarë deklaratimet me shkrim dhe kërkohet mendimi e vullneti i anëtarësisë se çfarë tutje lidhur me vlerën e koeficientit të pagave dhe për Kontratën e re Kolektive të Arsimit, pra çka tutje nëse Qeveria dhe MASHTI vazhdojnë me qasjen e gabuar ndaj dialogut dhe me heshtjen.

Edhe kësaj radhe do të veprojmë bashkërisht duke respektuar vullnetin dhe zërin e anëtarësisë dhe jemi të gatshëm për sfidat e kohës.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Mësimdhënësit e Prishtinës të pakënaqur me paga dhe mungesën e Kontratës Kolektive



Mësimdhënësit e Prishtinës vazhdojnë të kontribuojnë në edukimin e gjeneratave të nxënësve, gjë të cilën e bëjnë me shumë përkushtim, vullnet dhe dashuri.

Qindra mësimdhënësit kryeqytetit të cilët janë edhe anëtarë të SBASHK-ut, punën e bëjnë me shumë përkushtim edhe pse ndonjëherë u mungojnë edhe kushtet e punës dhe mjetet e nevojshme për procesin mësimor.

Megjithatë, vullneti i mësimdhënëseve prishtinas për kontribut në arsim si dhe në SBASHK, vazhdon të rritet dita e ditës. Këtë e thonë edhe statistikët e regjistrimit të anëtarësisë si dhe kërkesa e tyre për t'u pajisur me kartelat e anëtarësisë së SBASHK-ut.

Lidhur me gjendjen në arsimin e Prishtinës, në numrin tetor të gazetës së SBASHK-ut, ka folur kryetarja e Sindikatës për Arsimin Parauniversitar në Prishtinë, Drita Dushi, e cila në këtë pozitë është emëruar në fillim të këtij viti.

SBASHK: Cilat janë arritjet e SBASHK-ut në Prishtinë prej marrjes së mandatit nga ju?

Drita Dushi: Prishtina është një qendër e madhe e anëtarëve të Sindikatës e cila ka kontribuar shumë gjatë në ngritjen e zërit të mësimdhënëseve për të drejtat e tyre, e po ashtu në punën e palodhshme sindikale me dekada të tëra. Mendoj që Prishtina e ka trasuar rrugën sindikale me vite të tëra, dhe nga anëtarë të devotshëm përgjatë mbi

dy dekadave, derisa puna ime mbetet të vazhdoj në këtë rrugëtim përplot me sfida për mësimdhënësin por edhe nxënësin dhe cilësinë në mësimdhënie në përgjithësi. Si arritje përgjatë këtyre muajve të fillimmandatit, mund të them se është rritur numri i anëtarëve në SBASHK, gjë e cila mund të shihet edhe me kërkesën e çdoditshme të mësimdhënëseve për pajisje me kartela të Sindikatës, megjithëse nuk posedoj aktualisht shifra konkrete për një gjë të tillë.

SBASHK: Sa është interesimi i mësimdhënëseve të Prishtinës që të ndjekin trajnimet e licencuara nga SBASHK?

Drita Dushi: Mësimdhënësit në Prishtinë sikur edhe në gjithë vendin, kanë obligime dhe përgjegjësi profesionale ndaj punës së tyre, institucioneve dhe nxënësve në veçanti. Për t'i ngritur kapacitetet profesionale, edukative dhe arësimore dhe në mënyrë që të jenë çdoherë e më të avancuar në mësimdhënie, ata duhet që të ndjekin trendet në mësimdhënie dhe të përgatiten çdo ditë. Një ndër mënyrat për zhvillimin e njohurive në mësimdhënie dhe ecjen në hap me trendet në fushën e arsimit, është edhe zhvillimi përmes trajnimeve që SBASHK-u organizon për mësimdhënësit-anëtarë të vet. Andaj, mësimdhënësit e Prishtinës sikur edhe gjithë Kosovës, janë shumë të interesuar që t'i ndjekin trajnimet të cilat SBASHK-u i organizon dhe ofron pa pagesë për anëtarësinë, në mënyrë që cilësia në arsim të jetë në hap me trendet më të reja dhe më të avancuara të mësimdhënies. Si rrjedhojë, certifikimi nga këto trajnime, mësimdhënëseve u shërben edhe për licencim dhe rilicencim, andaj interesimi i mësimdhënëseve për ndjekjen e këtyre trajnimeve është mjaft i lartë.

SBASHK: Cilat janë shqetësimet e mësimdhënëseve në Prishtinë?

Drita Dushi: Shqetësimet e mësimdhënëseve kryesisht janë me rilicencimin pasi në shumë shkolla në kryeqytet mungon vlerësimi i brendshëm pasi nuk është bërë nga shkolla, dhe kjo është njëra ndër kushtet pse nuk po mund të përfundoj procesi i rilicencimit. Por, mësimdhënësit kanë edhe shqetësime tjera, pasi sipas tyre nuk po vlerësohet sa duhet nga institucionet puna e mësimdhënëseve, nuk po i'u respektohen të drejtat që i kanë me Kontratën Kolektive. Mësimdhënësit kanë shprehur shqetësim edhe sa i përket vlerës së koeficientit pasi që mendojnë se është shumë e ulët dhe nën nivelin e pagave në rajon. Megjithatë, mësimdhënësit kërkojnë rritje të vlerës së koeficientit dhe nuk duan që këtë t'a arrijnë me greva por me dialog social.

Gjatë muajit

Në SBASHK vendoset ashtu siç thotë anëtarësia



SBASHK / UESCK
Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës
The Union of Education, Science and Culture of Kosovo

Deklarim më shkrim për veprime sindikale

Me nënshkrimin tim, vullnetarisht deklaroj se në qoftë se më së largu 10.11.2024 dështojnë përpjekjet që më dialog social në mes të SBASHK dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të arrihet pajtueshmëri, që të realizohen kërkesat tona si anëtarë të SBASHK-ut për:

1. Nënshkrimin e Kontratës Kolektive të arsimit në Kosovë të dorëzuar në MASHTI më datën 02.10.2024.
 2. Negocimin e vlerës së koeficientit të pagave për vitin 2025.
- Obligohet Kryetari i SBASHK-ut, që duke u bazuar në Ligjin për organizimin sindikal dhe Ligjin për Grevën, të fillojë menjëherë veprimet e përshkallëzuara sindikale, duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme, ashtu saç thuhet në ligjet e lartcëkura deri në realizimin e kërkesave tona.

Shoqata sindikale: _____, Komuna: _____

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. personal	Telefoni	Nënshkrimi
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				


SBASHK ka mbajtur takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e të punësuarve në arsim, që nga çerdhet e deri edhe në universitete duke analizuar situatën aktuale e duke debatuar për kërkesat legjitime të anëtarësisë. Në

këto takime janë përcaktuar edhe detyrat konkrete, që janë realizuar falë angazhimit të stafit qendror dhe të veprimtarëve sindikal në tërë Kosovën. Kështu për një kohë të shkurtër u mbledhën nënshkrimet dhe u dërgua nisma qytetare lidhur me Projektligjin për plotësim-ndryshimet në Ligjin e skemave pensionale. Po ashtu u punua me kujdes Draft Kontrata e re Kolektive e Arsimit dhe në kohën e përcaktuar dhe u dorëzua në MASHTI bashkë me kërkesën që të nisë negociimi për Kontratën e re Kolektive të Arsimit dhe të nënshkruhet pastaj nga MASHTI dhe SBASHK-u.

U dërgua në emër të anëtarësisë më 3 shtator edhe kërkesa në Qeveri për ngritje urgjente të vlerës së koeficientit për së paku 30%. Por, duke parë se Qeveria dhe MASHTI vazhdojnë me qasjen e gabuar ndaj dialogut me përfaqësuesit e të punësuarve në sektorin e arsimit, në takimin e SBASHK-ut u vendos që të përgatitet një formular unik për deklarinimin e anëtarësisë, se çfarë të veprohet nëse Qeveria vazhdon të hesht ndaj kërkesave legjitime të anëtarësisë së SBASHK-ut. Ky formular për deklarinim është shpërndarë nëpër gjithë shoqatat sindikale dhe për disa ditë pritet të dihet se cili është mendimi i anëtarësisë për veprimet në vijim. Ky aktivitet i anëtarësisë bëri që Qeveria të bëjë ca hapa edhe për ngritje pagash me lëvizje të koeficienteve në janarin e vitit të ardhshëm, por kjo është kritikuar arsyeshëm nga SBASHK dhe shumë sindikata të tjera, ngase ngritja e propozuar dhe e paralajmëruar nga Qeveria është e papranueshme për sektorin e arsimit.

Në SBASHK po përcillet me kujdes situata aktuale dhe si gjithmonë, edhe kësaj radhe do të veprohet ashtu siç thotë anëtarësia.

SBASHK vlerëson se rritja e paralajmëruar prej 55 euro e pagave është e papranueshme



Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut, duke respektuar zërin tuaj, ne ishim angazhuar që me shkresa e dialog të kërkojmë nga qeveria që vlera e koeficientit të pagave të shtohet për së paku 30 %, por kryeministri Kurti dhe ministri Murati, në mënyrë të njëanshme dolën para medieve dhe pa as edhe një konsultim me sindikatat


deklaruan se do të bëjnë një lëvizje, jo në vlerën e koeficienteve, por në vet koeficientet duke premtuar një lëvizje në janar prej 0.5 të njësisë, që përkthyer në vlerë monetare i bie një rritje prej 55 euro bruto, që është irrituese dhe e papranueshme, sepse nuk ka as edhe një ndikim në forcën blerëse të pagave kur dihet se çmimet kanë shënuar rritje të mëdha gjatë gjithë vitit.

Ky veprim i kryeministrit Kurti dhe ministrit Murati, ka shtuar pakënaqësitë te anëtarësia e SBASHK-ut dhe ne jemi në pritje të ardhjes në selinë e SBASHK-ut të deklarimeve të anëtarësisë, se cilat do të jenë veprimet e radhës dhe i premtojmë anëtarësisë, se do të vazhdojmë me angazhimet për t'i zgjedhur çështjet me dialog, por do të respektojmë edhe tani, si gjithmonë, vullnetin tuaj anëtare e anëtarë të nderuar të SBASHK-ut.



Gjatë muajit tetor SBASHK mbajti një numër të madh të trajnimeve për mësimdhënës




Gjatë muajit tetor, me kërkesë të mësimdhënësve anë e kënd Kosovës, SBASHK-u ka organizuar një numër të madh të trajnimeve për mësimdhënësit anëtar të Sindikatës. Dy grupe të trajnimit të cilat po mbaheshin nga shtatori i këtij viti në programin “*Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie*” në **Pejë**, përfunduan, ku mësimdhënësit të cilët e kaluan testin me shkrim, edhe u pajisën me certifikata.




Ndërsa, trajnime të reja filluan në **Prizren** në programin “*Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie*” në dy grupe si dhe programin “*Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social*”, në dy grupe. Trajnimet e filluara nga trajnerët: z. Albert Samadraxha, z. Emin Hoxha, z. Hysen Sogojeva e z. Safet Beqiri, gjatë mbajtjes së ligjëratave i vizitoi kryetari i SBASHK-ut, z. Rahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri dhe zyrtaren znj. Nezafete Jakupi. Përfaqësuesit e SBASHK-ut në Prizren bashkëbiseduan për çështje aktuale dhe falënderuan kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prizrenin, z. Reshit Kushaj, anëtarin e Këshillit Drejtues, znj. Hyrie Hoti dhe veçmas drejtoreshen e Shkollës Profesionale “Ymer Prizreni”, znj. Myvedete Gavazaj, për mikpritjen dhe mundësimin e organizimit të këtij aktiviteti.



Gjatë vikendit të parë të tetorit, SBASHK kishte filluar me trajnime edhe në **Vushtrri e Mitrovicë** me nga një grup të mësimdhënësve në programin “*Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie*”, me trajnerë z. Kadri Hyseni dhe z. Nexhmedin Gruda. Po në Mitrovicë filloi edhe grupi i parë i trajnimit për muajin tetor, në programin “*Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social*”, me trajner z. Skender Gashi. Mësimdhënësit pjesëmarrës në këto trajnime, gjatë vikendit i kishte vizituar kryetari i SBASHK-ut, z. Rahman Jasharaj, nënkryetarja znj. Vjollca Shala dhe koordinatori për zhvillim të brendshëm, z. Ymer Ymeri. Përfaqësuesit e SBASHK-ut, mësimdhënësve u dëshiruan suksese sa më të larta në trajnimet e organizuara për anëtarësinë, derisa e përcollën nga afër mbarëvajtjen e këtyre trajnimeve. Përfaqësuesit e SBASHK-ut gjatë këtij vikendi kishin qëndruar edhe në Prizren për të parë nga afër mësimdhënësit pjesëmarrës në këto trajnime.



Po ashtu, gjatë këtij muaji, me dy grupe të mësimdhënësve filloi trajnimi në programin “*Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie*” në komunën e **Lipjanit**.



Reagimi i ETUCE - Unionit të sindikatave të arsimit të Evropës

Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës me kërkesa të qarta për Qeverinë e Kosovës.

Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës me seli në Bruksel, ka përgëzuar vazhdimisht SBASHK-un për angazhimet e shumta e të vazhdueshme në shërbim të anëtarësisë. Ky Union, që përfaqëson 11 milionë mësimdhënës nga e tërë Evropa, ka shprehur me deklaratime publike dhe me shkresa drejtuar Kryeministrit Kurti dhe Qeverisë së Kosovës, mbështetjen e fuqishme për sindikatën anëtare të tyre. Kështu ndodhi edhe me letrën e këtyre ditëve, nënshkruar nga kryetari i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Larry Flanagan, drejtuar Kryeministrit Kurti, ministrit Murati dhe ministres Nagavci, përmes të cilës ai shpreh mbështetjen e fuqishme për SBASHK-un në emër të 11 milionë anëtarëve të këtij Unioni e duke shprehur kërkesa të qarta sindikale për Qeverinë që të ketë qasje

të duhur ndaj SBASHK-ut dhe sindikatave të tjera dhe që të funksionalizojnë Këshillin Ekonomik Social dhe të nisin me dialogun e sigurtë për të gjitha kërkesat duke nënshkruar Marrëveshjen Kolektive në nivel vendi dhe Kontratat Kolektive për Arsimin e Kosovës dhe me sektorët tjerë.

Kryetari Flanagan ua kujton Kurtit, Muratit e Nagavcit, se Kosova është një vend kandidat potencial për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe se një element kyç në këtë rrugëtim është edhe dialogu social i Qeverisë, ministrive me SBASHK-un dhe sindikatat tjera. Kjo letër solidariteti me SBASHK-un dhe me kërkesat e këshillat e qarta nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës, është dërguar në adresën e Kryeministrit Kurti dhe në atë të ministrit Murati e ministres Nagavci dhe urojmë që ta lexojnë me kujdes dhe të ndryshojnë qasjen ndaj dialogut dhe ndaj sindikatave.



Inclusive working conditions and pension schemes to attract and retain skilled and passionate teachers and other education personnel.

The level of salaries and demands for higher quality education as well as reforms increasing the dignity of workers, teachers' autonomy, ensuring higher salaries, the abolition of administrative reforms, the adoption of pedagogical standards with the consent of the trade unions, and a better reform of curricula have been central matters in a variety of letters, proposals and suggestions that SBASHK shared with your Government.

Our member organisation SBASHK reported to us that Kosovo has lacked a social economic Council for over two years, which has directly impacted the absence of dialogue between State institutions and trade unions; a concern that SBASHK has continuously expressed to both national and international institutions.

Kosovo has not had a collective agreement for six years. The sectoral collective contracts, negotiated by the education trade union and the health sector trade union, were unilaterally severed by the relevant ministries.

Moreover, we are informed that the Government continues to change the existing law to the detriment of workers and pensioners, denying their rights, in violation of the ILO conventions. As a result of these violations, the Constitutional Court returned many laws to be improved and amended. In recent months, SBASHK has taken concrete actions in order to improve these violations mentioned above. The petition launched by SBASHK to amend the law on pension schemes financed by the state, which was changed in 2023 to the detriment of education workers, collected 20 000 signatures in few days.

On 30 September 2024, SBASHK submitted the draft law to the Speaker of the Assembly of Kosovo, Mr. Gëzim Karavica, and now expects that it will be submitted to the Assembly and voted on by the deputies of Kosovo, within the legal deadline of two months.

SBASHK also prepared the draft for a new Collective Contract, after a long process of consultation with its membership and civil society. This Collective Contract was intended to be sent to the Minister of Education, Science, Technology and Innovation to be negotiated and eventually signed. We have to note that, to date, the Minister has not replied to the invitation coming from SBASHK to discuss such text.

For this reason, on 1 October, SBASHK will submit the draft Collective Contract at the presence of the media as a protest for the absence coming from the Ministry.

With our letter we intend to call on the Prime Minister, the Ministry of Finance, and the Minister of Education, Science, Technology and Innovation, to open a dialogue with the trade unions, sign the General Agreement and the Sectoral Collective Contracts, and halt any further attacks on SBASHK.

As Kosovo is a potential candidate country to join the European Union, we also wish to remind of the role and the position that social partnership plays in the EU, as recognised in the recent European Commission Communication "Strengthening social dialogue in the European Union" (COM(2023) 40 final) and in the Council Recommendation on the same matter (C(2022)1389).

ETUCE supports SBASHK and insists on the correct implementation of principle no. 8 on social dialogue and improvement of workers of the European Pillar of Social Rights, in the respect of ILO Convention No. 144 and Recommendation No. 152 on Tripartite Consultation.

ETUCE believes that that democratic values and principles of social partners have to be respected and the government has to engage in a meaningful and positive social dialogue with trade unions. Ensuring a high-quality educational process requires energetic, creative and motivated teachers with employment stability, decent and competitive salary, and decent workload.

We continue closely monitoring the situation and support SBASHK and its members in their fight for effective and immediate implementation of the social dialogue outcomes in Kosovo.

Yours sincerely,


Larry Flanagan
ETUCE President

SBASHK mbështet vlerat edukativo-arsimore.

Në kuadër të "Javës së Edukimit Global mbi Median dhe Informacionin", në Departamentin e Gazetarisë në UP janë prezantuar gjetjet e hulumtimit me titull "Ndikimi i medieve sociale te nxënësit në Kosovë – një studim nga perspektiva e mësimdhënësve", nga profesorët z. Arben Fetoshi dhe z. Faton Ismaili. Ky hulumtim është ndihmuar nga SBASHK-u me realizimin e anketave me mësimdhënës dhe nxënës të klasave të 5-ta në shkollat e Kosovës, derisa kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, tha se rezultatet e hulumtimit tregojnë domosdoshmëri të përfshirjes së lëndës së edukimit medial në shkollat e Kosovës. Kryetari i SBASHK-ut në fjalën përshëndetëse



ka falënderuar prof. dr. Alban Zeneli dhe gjithë profesorët e këtij Departamenti për bashkëpunimin dhe për angazhimet maksimale të tyre në realizimin e trajnimit me mësimdhënësit nga e tërë Kosova lidhur me edukimin medial. Z. Jasharaj ka shtuar se realiteti në shkolla dhe ngjarjet që po ndodhin mes nxënësve duke përdorë në mënyrë të pakontrolluar disa medie sociale, forcon arsyen dhe idenë e SBASHK-ut dhe Departamentit të gazetarisë që MASHTI të vendos, që lënda për edukimin medial të jetë lëndë obligative dhe të vazhdohet edhe me trajnimin me mësimdhënës për edukimin medial.



Shoqata Sindikale “Posta” vizitoi SBASHK-un



Kryetari i Shoqatës Sindikale “Posta”, z. Liridon Mirena, bashkë me nënkryetarin, z. Faton Morina e anëtarin e kryesisë, z. Sami Maqedonci, kanë vizituar selinë e SBASHK-ut dhe kanë zhvilluar një bashkëbisedë me kryetarin e SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, nënkryetaren, znj. Vjollca Shala e koordinatorin për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri. Mysafirët kanë shprehur respekt të lartë e meritë për gjithë angazhimet dhe për arritjet e shumta në realizimin e kërkesave SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Ata pastaj kanë treguar për angazhimet që Sindikata e tyre po bën për të qenë zë i vërtetë i anëtarësisë. Z. Mirena, z. Morina e z. Maqedonci kanë treguar me krenari se falë angazhimit e përkushtimit janë bërë anëtare me të drejta të plota edhe në Unionin e Sindikatave bashkë me 5 milionë kolege e kolegë nga e tërë Evropa dhe se gëzojnë vazhdimisht përkrahjen e tyre.

Ata kanë treguar edhe për sfidat e shumta duke kritikuar mungesën e gatishmërisë së institucioneve për dialog. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë njoftuar mysafirët për angazhimet e shumta në shërbim të anëtarësisë, por edhe për sfidat dhe për situatën aktuale në arsim duke përsëritur kritikën e argumentuar ndaj Qeverisë dhe në veçanti ndaj MASHTI-t për qasje të gabuar ndaj dialogut dhe sindikatave në përgjithësi. Të dy palët janë pajtuar që ta forcojnë bashkëpunimin dhe të mbështesin njëra-tjetrën në aktivitete e veprime sindikale. Me qëllim që të forcohet bashkëpunimi dhe zëri sindikal, përfaqësuesit e SBASHK-ut u kanë bërë apel përfaqësuesve të Shoqatës Sindikale “Posta” që të komunikojnë me anëtarësinë dhe të bëhen anëtare e BSPK-së.



Edhe dy marrëveshje bashkëpunimi nga SBASHK



SBASHK gjatë muajit tetor ka arritur të lidhë edhe dy marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme të cilët ofrojnë zbritje të produktet e tyre për anëtarësinë Sindikatës. Në kuadër të angazhimeve në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi “Pulse Electronice”. Për të shprehur mirënjohjen tonë për punën e përkushtuar arsimore e




edukative të punëtorëve të arsimit, jemi të lumtur të ju njoftojmë se në bazë të kësaj marrëveshjeje, anëtarët e SBASHK-ut do të përfitojnë një zbritje ekskluzive prej 10% në të gjitha shërbimet dhe produktet, përfshirë edhe laptopët dhe kompjuterët. Kjo zbritje aplikohet edhe të produktet që janë me oferta mujore. “Pulse Electronics” e ka selinë në Qytezën Pejton në Prishtinë dhe në rr. Wesley Clark në Prizren. Marrëveshja vlen për të gjithë anëtarët e SBASHK-ut nga e tërë Kosova dhe komunikimi fillestar mund të bëhet përmes numrit 045 755 000. Kjo marrëveshje në një ceremoni rasti është nënshkruar në selinë e SBASHK-ut nga z. Butrint Bërdynaj në emër të “Pulse Electronics” dhe nga z. Rrahman Jasharaj në emër të SBASHK-ut.

Po ashtu, gjatë muajit tetor SBASHK në Kamenicë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me laboratorin

“Bio Care”. Anëtarët e SBASHK-ut i kujtojmë se në kuadër të angazhimeve në shërbim të anëtarësisë edhe në Kamenicë është nënshkruar një Marrëveshje bashkëpunimi. Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit parauniversitar për këtë komunë, z. Lulzim Thaqi ka nënshkruar këtë marrëveshje me z. Artan Maliqi, përfaqësues i laboratorit “Bio Care”.

Në këtë marrëveshje që është shprehje e respektit për punën e përkushtuar të punëtorëve arsimor, anëtarë të SBASHK-ut për arsimimin dhe edukimin e brezave thuhet se anëtarët e SBASHK-ut gëzojnë zbritje prej 20% nga çmimi aktual për të gjitha shërbimet në këtë laborator. Zbritje prej 15 % për gjithë këto shërbime gëzojnë familjarët e anëtarëve të sindikatës sonë. SBASHK-u falënderon z. Maliqin dhe gjithë stafin e këtij Laboratori për respektin e treguar ndaj SBASHK-ut dhe punëtorëve arsimorë.



SBASHK mori pjesë në aktivitetin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës si dhe Kongresin e Federatës së Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë

SBASHK gjatë muajit tetor ishte pjesë edhe e disa aktiviteteve arsimore në rajon dhe Evropë, ku i përfaqësoi mëismdhënësit e Kosovës në Lisbonë të Portugalisë dhe Shqipëri.

Gjatë qëndrimit dyditor në Portugali, SBASHK mori pjesë në aktivitetin me temën “Sindikatat mbështesin përfshirjen e refugjatëve dhe emigrantëve në arsim” i cili qëllim kryesor kishte përfshirjen e të shpërngulurve nga vendet e tyre, në procese arsimore. Në këtë tryezë tematike mori pjesë edhe SBASHK-u, i përfaqësuar nga nënkryetarja, znj. Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri, të cilët u prezantuan para pjesëmarrësve me përvojat nga e kaluara jo shumë e largët, që ktheu kujtesën te kolegët sindikalistë nga e tërë Evropa për vitet e vështira të Kosovës dhe për zhvendosjen biblike të popullatës për shkak të dhunës, vrasjeve dhe tmerrit që kishte krijuar makineria vrastare e pushtuesit. Përfaqësuesit e SBASHK-ut treguan se si sindikata që përfaqësojnë e mbështetur nga Internacionalja Botërore e Arsimit

dhe sindikatat simotra nga disa vende mike, arritën të organizojnë në mirëkuptim me shtetin shqiptar dhe institucionet në Maqedoni të Veriut e Mal të Zi, mësimin për gjithë fëmijët e Kosovës, që ishin zhvendosur bashkë me familjet e tyre.



Organizatori dhe diskutuesit në këtë tryezë tematike janë shprehur plot shqetësim se përfshirja e emigrantëve dhe refugjatëve në arsim në vendin e mikpritjes nuk është e lehtë, sepse fëmijët të zhvendosur nuk e njohin gjuhën e rrethit të ri, vijnë nga një sistem ndryshe i arsimit, janë të stresuar e plot dhembje, sepse edhe familjet i kanë të ndara e të përgjysmuara dhe nuk dihet për fatin e anëtarëve të familjes, e po ashtu aty e këtu hasin edhe në

diskursin nacionalist nga partitë me prirje nacionaliste e ekstremiste. Pjesëmarrësit e kësaj tryeze tematike ishin zotuar se do të përgatitin e aprovojnë një Plan të përbashkët veprimi për barazinë dhe gjithëpërfshirjen në sistemin arsimor të shteteve të tyre për t'ua lehtësuar dhembjen emigrantëve dhe refugjatëve. Gjatë tetorit, SBASHK po ashtu ishte pjesë e Kongresit të Federatës së Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë. Në Kongresin e 9-të të Federatës së Sindikatave të Arsimit e Shkencës së Shqipërisë ku edhe u zgjodh udhëheqësia e re, SBASHK mori pjesë në mesin e shumë sindikatave të arsimit nga shtete të ndryshme. Në hapje të Kongresit, kryetari i kësaj Federate, Isa Rekaj, ka përshëndetur mysafirët dhe delegatet e delegatët e pastaj është ndalur në aktivitetet e angazhimit e anëtarësisë, duke kujtuar sfidat por edhe arritjet e shumta sindikale.



Duke përshëndetur Kongresin, kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, veç tjerash, në emrin e tij, të nënkryetares Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe gjithë anëtarësisë së SBASHK-ut, ka falënderuar mikpritësit për bashkëpunimin, duke apeluar që kjo Federatë të vazhdojë rrugëtimin për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe në mbrojtjen e figurës së mësuesit, që ishte dhe mbetet i denjë në misionin e shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave. Përfaqësuesit e SBASHK-ut gjatë pjesëmarrjes në këtë Kongres kanë pasur takime me udhëheqës të sindikatave dhe mysafirë në këtë ngjarje të veçantë për arsimin e Shqipërisë.



Mbi 775 mësimdhënës të komunës së Vitisë, nuk e morën pagën e muajit shtator me kohë për çka edhe pati reagime e protesta

Për probleme financiare të Komunës së Vitisë, mësimdhënësve të kësaj komune, paga e shtatori iu vonua për më shumë se një javë, për çka pati reagim nga kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, derisa kryetarët e shoqatave sindikale të kësaj komune të përkrahur edhe nga përfaqësues tjerë të SBASHK-ut dhe BSPK, më 4 tetor mbajtën edhe një protestë të qetë njëorëshe para Qeverisë. Kryetari Jasharaj me këtë rast tha se është mëkat se mësimdhënësit do të përballen edhe me kamata shtesë, derisa i luti bankat që mos të veprojnë dhe të mos i ndëshkojnë mësimdhënësit pasi tha se qeverisja i ndëshkoi.



Paraprakisht, mësimdhënësit e kësaj komune ishin vizituar edhe nga përfaqësuesit e SBASHK-ut, kryetari Rahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe

koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, duke ndarë shqetësimin me mësimdhënësit e Vitisë për mosekzekutimin e pagave sipas Ligjit në fuqi. Përfaqësuesit e SBASHK-ut, gjatë vizitës në Viti, ishin pritur nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, Kemajl Bislimi, kryetari i Vitisë, z.Sokol Haliti, me të cilët kishin shprehur shqetësimin për situatën e krijuar. Kryetari Haliti dhe përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin apeluar te Ministria e Financave që të angazhohet sinqerisht dhe të procesojë pagat edhe për punëtorët e arsimit në Viti, derisa ishin shprehur se qëndrojnë pranë punëtorëve arsimorë të kësaj komune dhe do të jenë pjesë e çdo angazhimi e veprimi të tyre.



SBASHK i kishte bërë thirrje edhe ministrit të Financave, Hekuran Murati qysh më datën 1 tetor që të ekzekutohen pagat për mësimdhënësit e Vitisë. SBASHK-u shpreh shqetësimet e arsyeshme për mosekzekutimin me kohë të pagave për muajin shtator. Kujtojmë ministrin Murati se mos ekzekutimi me kohë i pagave për muajin shtator shkakton efekte negative financiare të punëtorët e arsimit dhe jo vetëm nga fakti se shumica e tyre jetojnë me atë pagë dhe mezi e lidhin fillimin e muajit me fundin e tij. Aq më keq, shumë prej tyre edhe janë në kredi dhe vonesa e ekzekutimit të pagave u krijon probleme shtesë ngase këstet e kredive janë të ndërlidhura me data dhe me daljen e pagave dhe kështu të punësuarit pa fajin e tyre mund të ndëshkohen me kamata shtesë për kreditë e tyre. SBASHK kërkon urgjentisht nga ministri Murati që të ndjehet përgjegjës për mos ekzekutimin me kohë të pagave të shtatorit dhe të shtojë angazhimet e të gjejë mundësi ligjore që ekzekutimi i pagave të bëhet

që sot, sepse në të kundërtën do të konsultohemi me anëtarësinë dhe duke respektuar zërin e tyre, mund të nisim me veprime sindikale, ishte thënë në reagimin e SBASHK-ut.



Jasharaj e quan armiqësore qasjen e Qeverisë ndaj sindikatave

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, e ka quajtur armiqësore qasjen e Qeverisë së Kosovës ndaj sindikatave në përgjithësi dhe SBASHK-ut në veçanti sa i përket dialogut social. Z. Jasharaj këto deklarime i bëri në tryezën e organizuar nga IKD me temë: Mungesa e Kontratave Kolektive – Dështimi për të siguruar dialog social dhe mbrojtje kolektive të punëtorëve. Sipas z. Jasharaj, Qeveria Kurti me qëllim e ka një qasje të gabuar ndaj dialogut social dhe ka një qasje që merr përmasat edhe armiqësore ndaj sindikatave, veçmas atyre që i sheh si të forta e që është Sindikata e Arsimit. Sipas tij, ëndrra e ministrit Murati është të shkatërrojë edhe SBASHK-un, por sipas z. Jasharajt, nuk do ia arrijë dhe se SBASHK është më i fortë se në të kaluarën. Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, e ka quajtur armiqësore qasjen e Qeverisë së Kosovës ndaj sindikatave në përgjithësi dhe SBASHK-ut në veçanti sa i përket dialogut social. Z. Jasharaj këto deklarime i bëri në tryezën e organizuar nga IKD me temë: Mungesa e Kontratave Kolektive – Dështimi për të siguruar dialog

social dhe mbrojtje kolektive të punëtorëve. Sipas z. Jasharaj, Qeveria Kurti me qëllim e ka një qasje të gabuar ndaj dialogut social dhe ka një qasje që merr përmasat edhe armiqësore ndaj sindikatave, veçmas atyre që i sheh si të forta e që është Sindikata e Arsimit. Sipas tij, ëndrra e ministrit Murati është të shkatërrojë edhe SBASHK-un, por sipas z. Jasharajt, nuk do ia arrijë dhe se SBASHK është më i fortë se në të kaluarën. Kryetari Jasharaj me këtë rast tha se punonjësit e arsimit nuk do ta pranojnë as rritjen e pagës prej 55 eurove nga janari i vitit të ardhshëm të premtuar nga kryeministrit Kurti, pasi siaps z. Jasharaj, një shumë e tillë e të hollave nuk arrin t'a mbulojë as për së afërmi rritjen e shpenzimeve të shportës familjare e cila e ka kapluar tregun vendor. Në këtë takim u debatua edhe nga kryetari i BSPK-së, z. Atdhe Hykolli dhe përfaqësuesit e IKD-së, z. Naim Jakaj dhe z. Gzim Shala, të cilët konstatuan se Qeveria e Kosovës nuk duhet t'i paraqes si kërcënim për institucionet, të drejtat ligjore që iu takojnë punëtorëve.

